

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                       |
|---------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Vendimi i Hagës/ Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë: Nuk mund të njollosë sakrificën e dëshmorëve                                                                                                                                      |
| ADRESA  | <a href="https://www.cna.al/kosova-bota/vendimi-i-hages-keshilli-i-ambasadoreve-shqiptare-nuk-mund-te-njollo-i474348">https://www.cna.al/kosova-bota/vendimi-i-hages-keshilli-i-ambasadoreve-shqiptare-nuk-mund-te-njollo-i474348</a> |
| BURIMI  | cna.al                                                                                                                                                                                                                                |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 16 shtator 2026, 14:17:06 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 14:04:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 1fdb0c2a8a2ecd88c0f4afe930cd440a850b9bd83fb35b4e7056954e498b4c18 |
| TEKSTI     | c599ecf5e819cd91f431a1cbbcd7cf956adf922faea1977e34c5f2764d666afb |
| PAMJA      | 245d7ffa02c72e2c12017bd1df29a25e61e34e547a7a373f5b6822dba84d629e |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 7e59138e2629d88a6afa46c4216e034c7b6d7a9b63a6487aafdf29e8f0d51818                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 485c8b8c8ba28305218c58e8c7791d525f1a193166e89422b0670a53018cd566                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7e59138e2629d88a6afa46c4216e034c7b6d7a9b63a6487aafdf29e8f0d51818>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English  
English

**E fundit!**

x

16:15 Kosova & Bota

Altin Krasniqi, djali i ish-kryetarit të Kuvendit të Kosov...

## Vendimi i Hagës/ Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë: Nuk mund të njollosë sakrificën e dëshmorëve



16 Shtator 2026, 16:04, Kosova & Bota CNA



Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë ka bërë një deklaratë në lidhje me vendimin e sotëm të Gjykatës së Hagës.

Në deklaratën e bërë, Këshilli shpreh zhgënjim të thellë dhe shpreh shqetësim për kohëzgjatjen e procesit dhe paraburgimit për ish-krerët e UÇK-së.

Këshilli i Ambasadorëve deklaron se asnjë vendim nuk mund të zhbëjë sakrificën e dëshmorëve dhe të mijëra viktimave.

#### Deklarata

*Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë (KASH) ka ndjekur me shqetësim të thellë shpalljen e aktgjykimit të shkallës së parë nga Dhomat e Specializuara të Kosovës me seli në Hagë ndaj ish-drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.*

*Duke respektuar parimet e shtetit të së drejtës, pavarësinë e institucioneve gjyqësore dhe të drejtën e çdo viktime për drejtësi, KASH shpreh zhgënjimin e tij të thellë për këtë vendim. KASH ngre, gjithashtu, shqetësime serioze për kohëzgjatjen e jashtëzakonshme të procesit, paraburgimin shumëvjeçar të të akuzuarve, proporcionalitetin e dënimeve dhe standardet e zbatuara gjatë këtij gjykimi.*

*KASH rikujton se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte një luftë e drejtë dhe çlirimtare kundër shtypjes, spastrimit etnik dhe dhunës sistematike të regjimit të Slobodan Millosheviçit. Kjo luftë gëzoi mbështetjen e botës demokratike, ndërsa ndërhyrja e NATO-s i dha fund një tragjedie humanitare që kishte detyruar rreth një milion shqiptarë të Kosovës të largoheshin nga shtëpitë e tyre.*

*Makineria shtetërore, ushtarake dhe policore e regjimit të Millosheviçit, si dhe drejtues të lartë të saj, janë gjykuar dhe dënuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë për krimet e kryera në Kosovë dhe në pjesë të tjera të ish-Jugosllavisë. Krimet e dokumentuara të këtij regjimi, vrasjet, masakrat, dëbimet me forcë dhe përndjekja sistematike e popullsisë civile, nuk mund të relativizohen dhe as të barazohen me luftën liridashëse të popullit të Kosovës dhe të udhëheqësve të tij.*


*Aktgjykimi ndaj katër ish-drejtuesve të UÇK-së nuk është dhe nuk mund të interpretohet si një dënim në emër të popullit të Kosovës, të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës apo të luftës së saj për liri dhe pavarësi. Asnjë vendim gjyqësor nuk mund të njollojë sakrificën e mijëra dëshmorëve dhe viktimave, të zhbëjë të drejtën historike të popullit të Kosovës për liri, apo të përmbysë dallimin themelor ndërmjet agresorit dhe viktimës. Historia e Kosovës dhe karakteri çlirimtar i luftës së saj nuk mund të rishkruhen.*

*Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë vëren se reagimet e para ndërkombëtare kanë rritur rëndësinë e drejtësisë dhe përgjegjshmërisë, ndërsa në Kosovë dhe në diasporë vendimi ka shkaktuar kundërshtime dhe shqetësime të mëdha. Në këtë kontekst, KASH u bën thirrje partnerëve ndërkombëtarë të Kosovës që të mbajnë një qëndrim të qartë dhe të balancuar: respektimi i proceseve gjyqësore nuk duhet të shndërrohet në relativizim të agresionit serb, në barazim moral të palëve apo në rishkrim të historisë së luftës çlirimtare të Kosovës.*

*KASH pret që procesi i apelimit të shqyrtojë me paanshmëri dhe rigorozitet të plotë provat, përfundimet juridike, mënyrën e përcaktimit të përgjegjësisë dhe proporcionalitetin e dënimeve, duke garantuar të gjitha të drejtat e të dënuarve për një proces të drejtë. Aktgjykimi i shpallur është i shkallës së parë dhe mjetet juridike ende nuk janë shteruar.*

*Njëkohësisht, Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë i bën thirrje bashkësisë ndërkombëtare që të zbatojë të njëjtat standarde drejtësie edhe ndaj krimeve masive të kryera nga forcat shtetërore serbe në Kosovë. Drejtësia nuk mund të jetë e plotë, e barabartë dhe e besueshme për aq kohë sa shumë prej përgjegjësve për masakrat, dëbimet, dhunën seksuale, shkatërrimet dhe zhdukjet me forcë vazhdojnë të mbeten të pandëshkuar.*

*Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë shpreh solidaritetin e tij me popullin e Kosovës dhe me familjet e të dënuarve, duke bërë thirrje për qetësi, unitet, dinjitet dhe besim në mjetet juridike të parashikuara nga ligji.*





---

## Të sugjeruara

Dënimi në Hagë për ish-krerët e UÇK-së/ DASH: Shmangni retorikën nxitëse, punoni për të ardhmen paqësore

Mekanizmi i alarmit i BE-së për krizat e sigurisë

BE fton Kanadanë të bëhet anëtarja e parë e asociuar

Vendimi i Hagës/ Kurti: Padrejtësi e papranueshme, ndëshkim i madh

Gjyqi i Hagës/ Avokatët e Krasniqit dhe Selimit shprehin zhgënjimin

Vendimi i Hagës/ LDK bën thirrje për përmbajtje, Osmani: UÇK, pjesa më krenare e historisë së Kosovës

Gjykata e Hagës dha dënim/ Avokati i Thaçit: Ditë e errët për drejtësinë

“Besa-Besë”/ Tensione para selisë së EULEX-it në Kosovë pas vendimit të Hagës

“Historia e Kosovës nuk rishkruhet sot”/ Kreu i PDK-së, reagim për dënimin e Thaçit dhe tre të tjerëve

Vendimi i Hagës për ish-krerët e UÇK-së/ Ali Ahmeti: Me besim në drejtësi, beteja vazhdon në apel

FOTO dhe VIDEO/ Përplasje të ashpra në Hagë pas vendimit, policia hedh ujë drejt protestuesve

Vendimi i Hagës/ Haradinaj: Jo në emër të popullit të Kosovës dënim për UÇK-në

“Padrejtësia më e madhe e shekullit”/ Reagimet e familjarëve të ish-krerëve të UÇK-së

Vendimi i Hagës/ Konjufca: Gjykim i tmerrshëm për Kosovën dhe për luftën çlirimtare

Shpërthime, thirrje dhe marshim/ Si u prit dënimi i ish-krerëve të UÇK-së në Prishtinë

Gjykata e Hagës shpall dënimin për Rexhep Selimin

Gjyqi i Hagës/ Jepet dënimi për Jakup Krasniqin

Gjyqi në Hagë/ Shpallet dënimi për Kadri Veselin


Shpallet vendimi në Hagë për Hashim Thaçin/ Ja me sa vite burg dënohet

Seanca në Hagë/ Gjykatësi, me akuza të rënda: Thaçi mori pjesë personalisht në krime  
[editorial](#)

14:40 Editorial Elvi FUNDO

Hashim Thaçi e la Kosovën të lirë/ Erion Veliaj nuk ndahet nga karrigia që i dha PS-ja

CNA LIVESTREAM





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.